VENDIM
Nr. 652, datë 12.11.2025

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 27.5.2025, PËR ÇËSHTJEN "ARB SHPK DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR KËRKESËN NR. 39860/19 DHE 3 KËRKESA TË TJERA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 27.5.2025, për çështjen "ARB sh.p.k., dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për kërkesën nr. 39860/19 dhe 3 kërkesa të tjera, përfundimtar më 27.8.2025, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse tij.
2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 27.5.2025, për çështjen "ARB sh.p.k., dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për kërkesën nr. 39860/19 dhe 3 kërkesa të tjera për secilën kërkesë.
4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesve "ARB sh.p.k." (kërkesat nr. 39860/19 dhe nr. 38996/20) dhe "Selman Gazidedja" (kërkesa nr. 27370/22) bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.
5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e përcaktuara në shtojcën 1, të këtij vendimi, paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin margjinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.
6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2025.
7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA 1
LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Numri i kërkesës	**Emri i çështjes**	**Kërkuesit**	**Dëm jopasuror**	**Kostot dhe shpenzimet**[1]
Nr. 39860/19 Nr. 38996/20	ARB sh.p.k. kundër Shqipërisë	ARB sh.p.k.	3.300 (tre mijë e treqind) euro 2.400 (dy mijë e katërqind) euro	1.500 (një mijë e pesëqind) euro 1.500 (një mijë e pesëqind) euro
27370/22	Selman Gazidedja kundër Shqipërisë	Selman Gazidedja	1.800 (një mijë e tetëqind) euro	2000 (dy mijë) euro

[1] Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.